

Bordi i Drejtorëve i NPL " Stacioni i Autobusëve"SH.A.,Prishtinë në pajtim me dispozitat e nenit 20 Ligjit nr. 04/L – 111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, neni 34 paragrafi 34.2 dhe 34.4 të Ligjit 03/L-087, si dhe bazuar në nenin 8 paragrafi 8.3 të Statutit e NPL " Stacioni i Autobusëve"SH.A.,Prishtinë në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 11.08.2018, miratoi:

RREGULLORJA PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIM E RREGULLORËS BAZË ME NR PROT: 02/527 TË DATËS: 25.06.2018 PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË PAGËS SI DHE ÇËSHTJEVE TJERA TË SUKSESIT TË PUNËS SË PUNËTORËVE TË NPL " STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A, PRISHTINË

Neni 1

QËLLIMI

Kjo rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e rregullores me nr prot: 02/527 të datës: 25.06.2018 për përcaktimin e kriterëve të pagës dhe çështjeve tjera të suksesit të punës së punëtorëve të NPL " Stacioni i Autobusëve"SH.A.,Prishtinë.

PËRCAKTIMI I PAGAVE SIPAS KRITEREVE DHE KOEFICIENTIT

Neni 2

2.1 Rregullores bazë me nr: 02/527 e datës: 25.06.2018 i shtohet llogaritja e pagës për pozitën " Mirëmbajtës i kamerave". Kjo pozitë hynë në kategorin e grupit:

GRU PI	Vendi i punës	Kriteri A	Kriteri B	Kriteri C	Kriteri D	Koeficienti	Vlera e koeficientit	Paga në euro
V – të	Mirëmbajtës i kamerave	5.4	0.99	1.35	1.26	9	61	549.00

2.2 Rregullores bazë me nr: 02/527 e datës: 25.06.2018 i shtohet llogaritja e pagës për pozitën “ Rojtar në administratë”. Kjo pozitë hynë në kategorin e grupit:

GRU PI	Vendi i punës	Kriteri A	Kriteri B	Kriteri C	Kriteri D	Koeficienti	Vlera e koeficientit	Paga në euro
IV – të	Rojtar në administratë	5.1	0.935	1.275	1.19	8.5	61	518.50

2.3 Rregullores bazë me nr: 02/527 e datës: 25.06.2018 i shtohet llogaritja e pagës për pozitën “ Punëtor në laura dhe tripod”. Kjo pozitë hynë në kategorin e grupit:

GRU PI	Vendi i punës	Kriteri A	Kriteri B	Kriteri C	Kriteri D	Koeficienti	Vlera e koeficientit	Paga në euro
III – të	Punëtor në laura dhe tripod	4.8	0.88	1.2	1.12	8	61	488.00

2.4 Rregullores bazë me nr: 02/527 e datës: 25.06.2018 i potësohet thirrja e vendit të punës nga “ Mirëmbajtës i hapësirave gjelbruese” dhe rifomulohet “ Mirëmbajtës i hapësirave të ndërmarrjes dhe gjelbrimit” dhe llogaritja e pagës për këtë pozitë hynë në kategorin e grupit:

GRU PI	Vendi i punës	Kriteri A	Kriteri B	Kriteri C	Kriteri D	Koeficienti	Vlera e koeficientit	Paga në euro
II - të	Mirëmbajtësit i hapësirave të ndërmarrjes dhe gjelbrimit	4.5	0.825	1.125	1.05	7.5	61	457.50

2.5 Rregullores bazë me nr: 02/527 e datës: 25.06.2018 i plotësohet vendi i punës “zëvendës Kry-punëtor i rojës së aseteve” llogaritja e pagës për këtë pozitë hynë në kategorin e grupit:

GRU PI	Vendi i punës	Kriteri A	Kriteri B	Kriteri C	Kriteri D	Koeficienti	Vlera e koeficientit	Paga në euro
VI – të	Zëvendës / Krye-rojtar i aseteve të ndërmarrjes	6	1.1	1.5	1.4	10	61	610.00

2.6 Rregullores bazë me nr: 02/527 e datës: 25.06.2018 i ndryshohet thirrja e vendit të punës nga “Kordinator i sigurimit” dhe riformulohet “Kry-rojtar i aseteve të ndërmarrjes” llogaritja e pagës për këtë pozitë hynë në kategorin e grupit VI (a) për shkak të kriterit B dhe kriterit D:

GRU PI	Vendi i punës	Kriteri A	Kriteri B	Kriteri C	Kriteri D	Koeficienti	Vlera e koeficientit	Paga në euro
VI (a)	Krye – rojtar i aseteve të ndërmarrjes	6	1.4	1.1	2.0	10.5	61	640.50

2.6 Rregullores bazë me nr: 02/527 e datës: 25.06.2018 i plotësohet thirrja e vendit të punës nga “ Punëtor i sigurimit” dhe riformulohet “Rojtar i aseteve në ndërmarrjes” llogaritja e pagës për këtë pozitë hynë në kategorin e grupit:

GRU PI	Vendi i punës	Kriteri A	Kriteri B	Kriteri C	Kriteri D	Koeficienti	Vlera e koeficientit	Paga në euro
III – të	Rojtar i aseteve në ndërmarrje	4.8	0.88	1.2	1.12	8	61	488.00

2.7 Rregullores bazë me nr: 02/527 e datës: 25.06.2018 i shtohet llogaritja e pagës për pozitën “ Garderoba”. Kjo pozitë hynë në kategorin e grupit:

GRU PI	Vendi i punës	Kriteri A	Kriteri B	Kriteri C	Kriteri D	Koeficienti	Vlera e koeficientit	Paga në euro
III – të	Garderoba	4.8	0.88	1.2	1.12	8	61	488.00

Neni 3

DIPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Pozitat tjera të Rregullores bazike me nr: 02/527 të datës: 25.06.2018 mbetet të pa ndryshueshme.


Neni 4

HYRJA NË FUQI

Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores bazë me nr: 02/527 të datës: 25.06.2018 për përcaktimin e kriterëve të pagës si dhe çështjeve tjera të suksesit të punës së punëtroëve të NPL " Stacioni i Autobusëve"SH.A.,Prishtinë, hynë në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve


Mr. Sc. Sherif Sejdiu - PhD



NDËRMARRJA PUBLIKE LOCALE STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.	
JAVNO PREDUZEĆE AUTOBUSKA STANICA D.O.O.	
PUBLIC ENTERPRISE LOCAL BUS STATION J.S.C.	
Nr. 02/527	Data 25.06 2018
No.	Date
PRISHTINË	

Bordi i Drejtorëve i NPL “Stacioni i Autobusëve”, SH. A., Prishtinë, në pajtim me dispozitat e nenit 20, të Ligjit nr. 04/L – 111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nenit 34 paragrafi 34.2 dhe 34.3 të Ligjit nr. 03/L – 087 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 13/2012), në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë: 23.06.2018, miratoi:

RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË PAGËS SI DHE ÇËSHTJEVE TJERA TË SUKSESIT TË PUNËS SË PUNËTORËVE TË NPL “ STACIONI I AUTOBUSËVE” SH.A, PRISHTINË

I. Dispozitat e përgjithshme.

Neni 1.

Me dispozitat e kësaj rregullorje caktohen kushtet dhe kriteret për caktimin e pagës (rrogës) bazë, si dhe për ngarkesa të posaçme në punë, sukses të punëtorit në punë dhe për sukses të afarizmit të NPL “Stacioni i Autobusëve” Sh.A, Prishtinë.

Neni 2.

Pos pagës bazë, paga (rroga) e të punësuarit mund të përcaktohet edhe nga shtesat për ngarkesa të posaçme në punë (puna e natës, puna më e gjatë se orari i plotë i punës, puna gjatë festave etj.) si dhe nga pjesa e pagës që bazohet në suksesin në punë dhe nga pjesa që bazohet në suksesin e afarizmit të ndërmarrjes.

Neni 3.

Paga bazë (fillestare) për punë përfshinë të gjitha elementet e ndërlikshmërisë, përgjegjësisë, vëllimit të punëve, përgaditjes respektivisht aftësimeve profesionale, si dhe shkathtësisë, gjegjësisht përvojat për kryerjen e atyre punëve.

Neni 4.

Të punësuarit të ndërmarrjes kanë të drejtë në shtesa për shkak të ngarkesave të posaçme në punë dhe rrezikshmërisë në punë.

Shtesat llogariten vetëm për kohen, gjatë së cilës, i punësuarit, ka punuar në ato kushte për të cilat i takon ajo.

Bazë për caktimin e shtesësh merret paga bazë e të punësuarit.

I punësuarit, nuk ka të drejtë në pjesën shtesë të pagës (rrogës), nëse kushtet e punës janë marr për bazë me rastin e vlerësimit të pagës (rrogës), për punë tipike.

Neni 5.

Të punësuarve të ndërmarrjes ju njihet e drejta në shtesë për përvojën e punës 0.5% të pagës bazë, për çdo vit të plotë të përvojës në punë.

Vitet e blera, të beneficuarra dhe përvoja e posaçme siguruese nuk konsiderohen si përvojë pune për realizimin e shtesës.

Neni 6.

Bazë për caktimin, respektivisht, vlerësimin e suksesit në punë është cilësia e kryerjes së punëve, ekonomizimi në punë, kreativiteti dhe inovacionet.

Sukseset në punë vlerësohen për individin ose mënyrën grupore.

Vlerësimin e suksesit në punë e bënë punëdhënësi me bashkëpunimin me mbikqyrësin e drejtëpërdrejt të punësuarit.

Neni 7.

Suksesi i afarizmit, konsiderohet afarizmi pozitiv i ndërmarrjes (realizimi i Planit të Biznesit), rezultatat i secilës është angazhimi i të punësuarve të saj i vlerësuar dhe i pranuar nga përgjegjësit e ndërmarrjes dhe strukturat relevante të saj.

Neni 8.

Pagat (rrogat) e të punësuarve të ndërmarrjes konsiderohen fshehtësi afariste e ndërmarrjes. Mos ruajtja e sekretit, respektivisht fshehtësisë afariste të ndërmarrjes është shkelje e rënd e punëve dhe detyrave të punëve, gjegjësisht konsiderohet se është rast i rëndë i sjelljes së keqe.

II. KRITERET PËR CAKTIMIN E PAGËS BAZË

Neni 9.

Kriteret për caktimin (rrogës) bazë, bazohet në këto metoda vlerësimi:

- a) Ndërlikueshmëria dhe përgjegjësia në punë 60%,
- b) Vëllimi i punëve 11%,
- c) Përgatitja profesionale 15%,
- d) Shkathësitë, përvoja 14%.

Një (1) koeficienti është 61.00 €

Raporti i punëve me ndërlikushmëri dhe përgjegjësi të lartë, e ato me ndërlikushmëri dhe përgjegjësi më të ulët do të jetë 1:2,46.

Neni 10.

- a) Ndërlikushmëria dhe përgjegjësia.

Ndërlikushmëria caktohet në punë në bazë të këtyre kriterëve:

Teknologjia lloji dhe rëndësia e punës;

Shkalla e përgaditjes profesionale e atyre punëve;

Përvojat, respektivisht aftësimet profesionale për kryerjen e tyre dhe angazhimet psiko – fizike për përmbushjen e detyrave të punës.

Neni 11.

Baza e përgjegjësisë në punë vlerësohet sipas këtyre kritereve;

- a) Përgjegjësia e kryerjes me sukses dhe në kohë të punëve (me afat);
- b) Përgjegjësia ndaj mjeteve të punëve dhe të mirave tjera materiale të ndërmarrjes;
- c) Përgjegjësia në procesin e punës (organizimin dhe koordinimin e punës); dhe
- d) Përgjegjësia e shërbimeve me interes për ndërmarrjen dhe më gjer;

Kriteret e ndërlikushmërisë dhe përgjegjësisë në punë marrin pjesë 60 %.

Neni 12.

Vëllimi i punëve

Baza për caktimin e vëllimit të punëve, merret realizimi (kryerja) e detyrave të parapara me planin e punës të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobuësve" Sh.A, Prishtinë.
Ky kriter merr pjesë me 11 %.

Neni 13.

Përgaditja profesionale

Kriteriumi i nevojës për përgaditjen profesionale, merr pjesë me 15 %.

Neni 14.

Shkathtësitë, përvojat

- Nevojat e shkathtësive, respektivisht përvoja në punë, merr pjesë me 14 %.
- Punët për të cilat nuk ka nevojë, respektivisht për kryerjen e të cilave nuk kërkohet përvojë në punë;
- Punët, për kryerjen e të cilave është e nevojshme përvoja në punë dhe
- Punët, për kryerjen e të cilave është e nevojshme përvoja adekuate në profesion.

Neni 15.

Në bazë të ndërlikushërisë, përgjegjësisë në punë, vëllimit të punëve, përgatitjes profesionale dhe përvojës së punës, shprehur në koeficient, punët dhe detyrat e punëve në ndërmarrje, vlerësohen me sa vijon:

PËRCAKTIMI I PAGAVE SIPAS KRITEREVE DHE KOEFICIENTIT

Tabela 1.

GRUPIMI SIPAS VENDEVE TË PUNËS, KRITEREVE DHE KOEFICIENTIT

Kriteret për caktimin e pagës	Kriteri A Ndërlikushmëria	Kriteri B Përgjegjësia	Kriteri C Përgaditja Profesionale	Kriteri D Përvoja	Koeficienti
Vlerësimi në Përqindje	60 %	11 %	15 %	14 %	100 %
Vlerësimi në Koeficient	10.33	1.89	2.58	2.41	17.21

Tabela 2.

GRU PI	Vendi i punës	Kriteri A	Kriteri B	Kriteri C	Kriteri D	Koeficienti	Vlera e koeficientit	Paga në euro
I - rë	- Pastrues	4.2	0.77	1.05	0.98	7	61	427.00
II - të	- Mirëmbajtësit e hapësirave gjelbëruese	4.5	0.825	1.125	1.05	7.5	61	457.50
III – të	- Sigurimi, dhe - informatat fonike - Informatat vizuale	4.8	0.88	1.2	1.12	8	61	488.00
IV – të	- Biletarët, - Inkasantët e autoparkut	5.1	0.935	1.275	1.19	8.5	61	518.50
V – të	- Likuidator/e - Manipulant/e - Dispiçerët, - Depoisti, - Furnizuesi, - Asistentët - Vozitësi - Punëtori në mirëmbajta të objekteve dhe aseteve	5.4	0.99	1.35	1.26	9	61	549.00

VI – të	<ul style="list-style-type: none"> - Koordinator i ndërrimeve - Kryepunëtor i sh. Teknik, - Koordinator i sigurimit - Asistent i Sekretarit/ es - Administrator për evidencë dhe udhëheqje të aseteve të ndërrmarjes - Kryepunëtor i mirëmbajtjes së objekteve dhe asteve - Teknik i transportit, - Bashkëpunëtor prokurimit - Faturisti-ja - Kontrollor-ja - Kontrolla financiare - Kontrolla e z-raportit - Protokolisti-ja - Teknologjia Informative - Arkivisti-ja, - Arkëtari-ja 	6	1.1	1.5	1.4	10	61	610.00
VII	<ul style="list-style-type: none"> - Kontrolla interne - Kontisti-ja, - Administratori i EVP-së - Përgjegjësi i Digjitalizimit 	6.6	1.21	1.65	1.54	11	61	671.00
VIII	<ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqësit i sh. Transportit - Udhëheqësi i sh. Teknik - Udhëheqësi i kontabilitetit - Udhëheqësi i pagesave - Zyrtari për informim - Zyrtari i BNJ - Zyrtari për mardhënie me klient, - Zyrtari ligjor, - Zyrtari i prokurimit, 	7.2	1.32	1.8	1.68	12	61	732.00

Vlera e koeficientit dhe koeficienti për pagë (rogë), janë përcaktuar duke u bazuar në Rregulloren mbi Organizimin e brendshëm dhe caktimin e titujve, detyrave dhe kompetencat e secilit punonjës dhe të punësuarve tjerë, në të cilën janë të përshkruara punët dhe detyrat e punës për çdo vend pune, nga të cilat rrjedhin edhe kriteret e lartë cekura në tabelat e mësipërme.

Paga e Kryeshefit Ekzekutiv, zv. Kryeshefave Ekzekutiv, Sekretarit Koorporativ, ZKFTH dhe Auditorës së brendshme të ndërmarrjes, caktohen nga Bordi i Drejtorëve të ndërmarrjes, me Deklaratën për Politiken e kompensimit, të përgatitur nga komisioni i Auditimit të ndërmarrjes (neni 20. paragrafi 20.4 dhe 10.5 si dhe neni 22. paragrafi 22.1, 22.2 dhe 22.3 të Ligjit nr. 03/L-87 për ndërmarrjet publike).

III. SHITESAT PËR SHKAK TË NGARKESAVE TË POSAÇME DHE RRËZIKSHMËRIN NË PUNË

Neni 16.

Punonjësi i angazhuar në punë më gjatë se orari i punës, ka të drejtë në rritje të pagës (rrogës) në lartësi prej 30 % në orë nga paga bazë.

Neni 17.

Punonjësi i angazhuar gjatë festave shtetërore apo fetare, ka të drejtë në rritje të pagës (rrogës) në lartësi prej 50 % në orë nga paga bazë.

Neni 18.

Punonjësi i angazhuar në punë gjatë natës, ka të drejtë në rritje të pagës (rrogës) në lartësi prej 30 % në orë nga paga bazë.

Punë nate konsiderohet puna prej orës 22h deri në 6h të mëngjesit.

Neni 19.

Për angazhimin në punë gjatë fund javës punonjësit i takon paga (rroga) shtesë prej 50 % paga bazë.

Neni 20.

Punonjësi ka të drejtë në shtesë të pagës, në bazë të kushteve të punës (angazhimi fizik dhe mendor, puna me palë, rrezikueshmëria në punë, zhurma, kushtet higjienike etj.).

Vlerësimin e kushteve të punës, konform dispozitave paraprahe e bën punëdhënësi në bashkëpunimin e drejtpërdrejt me mbikëqyrësin e tij.

Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës - për ditët e pranisë në punë me orar të plotë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, është 3 euro, varësisht nga rrethanat dhe mundësitë për raste konkrete.

Neni 21.

Punëdhënësi, me rastin e përcaktimit të pagës (rrogës) së punonjësve, duhet t'i ketë për bazë edhe cilësitë e punëve të kryera, ekonomizimi në punë (shpenzimet dhe shfrytëzimi racional i mjeteve të panënës), shfrytëzimi i kohës së punës kreativitetin dhe inovacionet.

Neni 22.

Punëdhënësi, me rastin e caktimit të pagës së punonjësve mund të merr për bazë edhe punën e kryer si rrethanë e posaçme e punës.

IV. KOMPENZIMI I PAGËS (RROGËS)

Neni 23.

Punonjësi ka të drejtë, në kompensim të pagës në rast të fatkeqësisë në punë sëmundjes profesionale, pushimit mjekësor, pushimit vjetor, ditëve të festave shtetërore, fetare dhe ato ndërkombëtare, në raste kur punonjësi dërgohet për shkollim, respektivisht aftësimi profesional, në rast të ndërprerjes të punës në ndërmarrje pa fajin e tij dhe në raste të tjera të parapara me ligj.

Neni 24.

Punëdhënësi duhet ta ndërpret kompensimin e pagës (rrogës) në rast se punonjësi angazhohet në punë tjera të përfitimit, nëse në afat prej 48 orësh nuk e njofton punëdhënësin se është i sëmurë dhe nëse nuk i përgjigjet ftesës për kontrollim mjekësor apo komision shëndetësor.

Neni 25.

Punëdhënësi, ka të drejtë që ta kontrollojë mungesën e punonjësve për shkak të sëmundjes.

Neni 26.

Baza për llogariten e kompensimit të pagës (rrogës) është paga për muajin paraprak (me orar të plotë të punës).

Në bazën për llogaritje të kompensimit për mungesë në punë, nuk llogaritet pjesa e pagës për punë më të gjatë se orari i plotë i punës dhe shtesat tjera për afarizëm të ndërmarrjes.

Neni 27.

Kompensimi i punëtorëve të ndërmarrjes që udhëtojnë në largësi më të gjatë se 40 km në një drejtim u kompensohen shpenzimet e udhëtimit në masën 100%, në bazë të dëshmimeve në vijim: vërtetimi i bashkësisë lokale ku banon duke e specifikuar saktësisht adresën e banimit si dhe çmimin e biletës ose mujores. Kompensimi i udhëtimit bëhet çdo muaj, pagesa e njëjtë futet në kuadër të kartelës së pagës.

V. PAGAT E PRAKTIKANTËVE

Neni 28.

Praktikant, konsiderohet person i cili për herë të parë krijon mardhënie të punës, me qëllim të aftësimit për punë të pavarur.

Punonjësi praktikant ka të drejtë në pagë (rrogën) bazë në lartësi prej 50 % të pagës së paraparë për kryerjen e punëve prë të cilat është duke u aftësuar, si dhe të drejtën në kompensim lidhur me punën.

VI. KOMPENSIMI I SHPENZIMEVE LIDHUR ME PUNËN

Neni 29.

29.1 Me rastin e pensionimit të punëdhënësi obligohet që t'ia paguaj punonjësit pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marrë në tre muajt e fundit të punës.

29.2 Afati i kërkesës së punëtorit drejtuar Ndërmarrjes Publike, për marrjen e tri(3) pagave duhet të behet brenda afatit 15 ditësh nga marrja e vendimit për pension.

Neni 30.

30.1 Në rast të vdekjes së punonjësit ose anëtarit të ngushtë të familjes së tij, respektivisht anëtari i ngushtë i familjes së tij, ka të drejtë në ndihmë solidare.

Lartësinë e ndihmës solidare e propozon punëdhënësi, e shqyrton dhe miraton Bordi i Drejtoreshave.

30.2 Punonjësit e ndërmarrjes kanë të drejtë në kompensimin e shpenzimeve dhe të mëditjeve gjatë kryerjes së punëve gjatë udhëtimeve zyrtare.

30.3 Lartësinë e mëditjeve (në Kosovë dhe jashtë), me vendim të veçantë e cakton punëdhënësi në përputhje me dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë çështje.

Neni 31.

Punëdhënësi, me vendim të veçantë mund t'i përcaktojë më për se afërmi bazat e suksesit në punë të punonjësve të ndërmarrjes (cilësia e punëve, ekonomizimi në punë, kreativiteti, inovacionet etj).

VII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 32.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje, mund t'i inicioj NP në pajtim me nenin 20 të Ligjit 04/L-111 për ndryshim plotësim të ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 33.

33.1 Me rastin e nënshkrimit dhe protokollimit të kësaj rregulloreje, pra të: Rregullores për përcaktimin e kriterëve, përkatëzi me përcaktimin e pagës (rrogës) bazë dhe kriterëve tjera të suksesit në punë të punëtorëve në NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A, Prishtinë, pushon të vlejë Rregullorja për përcaktimin e kriterëve, përkatëzi me përcaktimin e pagës (rrogës) bazë dhe kriterëve tjera të suksesit në punë të punëtorëve në NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A, Prishtinë me nr. protokoli 02/485 datë:10.05.2017, dhe çdo akt tjetër që ka interferuar në rregullimin e përmbajtjes së kësaj rregulloreje.

33.2 Të gjitha vendimet që bien ndesh me këtë Rregullore anulohen, mbizotërojnë dispozitat e kësaj rregulloreje në fuqi.

Neni 34.

Kjo Rregullore hyn ne fuqi nga 01.07.2018.

Kryesues i Bordit të Drejtorëve



Mr. Se. Sherif Sejdiu - PhD

